



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.29/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi - kryesues, Arsim Hamzaj, dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.06.2026, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.29/2026, e datës 07.06.2025, parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Më datë 07.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendohet se me datën 07 Qershor 2026 rreth orës 13:00 të pasdites në rrugën Ibri në Mitrovicën e Veriut, në afërsi të shkollës "Aziz Sylejmani është vërejtur një minibus në lëvizje me posteret e dy kandidatëve për deputet nga radhët e LVV – konkretisht Albin Kurtit, dhe Valon Pecit, duke bërë kësaj reklamim të tyre në ditën e zgjedhjeve, kur duhet edhe të respektohej heshtja zgjedhore. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë veprim është thyer heshtja zgjedhore dhe kësaj është shkelur neni 37, par.1, nen par.1.2 i LZP-së dhe neni 8, par.1, nen par.1.2. i Rregullores Zgjedhore nr.07/2024. Parashtruesi i ankesës në ankesë, ka bashkangjitur si prova fotot dhe CD. Andaj, ankuesi kërkon nga PZAP që t'i shqiptoj masën e sanksionit subjektit politik LVV.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) sqarohet se nga vetë materiali i bashkangjitur nga ankuesi, përkatësisht nga videoja dhe fotografitë e nxjerra nga

videoja, shihet se automjeti ka qenë në rrugë publike dhe se nuk behët fjalë për vendosje të materialit zgjedhor brenda qendrës së votimit, në oborrin e saj, në rrethojat e qendrës së votimit apo në ndonjë hapësirë të jashtme të qendrës së votimit. Poashtu, nuk provohet se automjeti ka qenë i parkuar e i pozicionuar për reklamim apo për t'iu drejtuar votuesve. Tutje, në përgjigje LVV pretendon se ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë për elementet vendimtare të shkeljes së pretenduar, nuk ka dëshmuar distancën nga hyrja e qendrës së votimit, nuk ka dëshmuar se automjeti ka qëndruar në afërsi të qendrës, nuk ka dëshmuar se nga automjeti është shpërndarë material, nuk ka dëshmuar se është kërkuar mbështetje nga votuesit dhe nuk ka paraqitur raport të menaxherit të qendrës së votimit, të KVV-së, të KKZ-së apo të Policisë dhe se një pamje e shkurtër e një automjeti në lëvizje nuk mjafton për të vërtetuar shkelje të nenit 37 par.1, nën par.1.2 të LZP-së. Në përgjigje, LVV gjithashtu sqaron se pretendimi se rasti ka ndodhur “ në afërsi” të Shkollës "Aziz Sylejmani" është i përgjithshëm dhe i pasaktësuar dhe se ankuesi nuk ka dëshmuar largësinë nga hyrja e qendrës së votimit, nuk ka ofruar matje, lokacion të saktë, raport të ndonjë organi zgjedhor, raport të policisë apo ndonjë konstatim nga menaxheri i qendrës së vendvotimit apo këshilli i vendvotimit. Andaj, subjekti politik LVV kërkon nga PZAP që ta refuzoj ankesën në tërësi si të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore, si dhe përgjigjen në ankese, gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), konstatoi se pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkuara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 8 par. 1 nën par.1.2 të Rregullores Zgjedhore nr.7/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së Zgjedhjeve dhe deklarimin financiar, si dhe nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “*Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndaloheq secili prej veprimeve si më poshtë: 1.2 “ bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*. Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së nenit 8 par. 1 nën par.1.2 të Rregullores zgjedhore nr.7/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar, si dhe nenit 37 par.1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast, videos se bashkëngjitur nuk mund të vërtetohet se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka bërë fushatë zgjedhore në ditën e zgjedhjeve, dhe se videoja është bërë në rrugë publike, dhe kalimi i minibusit në lëvizje me posteret e dy kandidateve per deputet nga radhet e LVV nuk vërtetohet se ka kryer aktivitet zgjedhor gjatë ditës së zgjedhjeve gjegjësisht nuk ka dëshmuar se ka pasur ndonjë qendër e votimit tek e cila ky minibus ka qëndruar përballë saj.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se :“*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se

pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme, dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.29/2026 më datën 09.06.2026



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.